



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 120

Prishtinë, më 30.10.2024, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Besnik Tahiri.

**Munguan:** Blerta Deliu-Kodra dhe Hajdar Beqa.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Vullnet Bugaqku, KDI.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 25.9.2024;
3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u shtuar si pikë e pestë: Shqyrtimi i raportit me*

*amendamente për Projektligjin nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 25.9.2024**

*Kryetari konstatoi se procesverbali i datës 25.9.2024, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat**

**Kryetari**, tha se ky është projektligj i Komisionit për Legjislacion, ku është trajtuar edhe në parim edhe në mes të dy leximeve. Komisioni ka bërë amendamentet, ka miratuar raportin me amendamente, dhe tani do të miratohet përfundimisht, pasi është miratuar nga komisionet kryesore. Kryetari shtoi për evidentim të procesverbalit, disa vërejtje (çështje) teknike që janë ndryshuar nga administrata, të cilat ndryshime teknike i prezantoi këshilltarja ligjore.

Këshilltarja ligjore tha se si rezultat i takimit të grupit të punës, e kemi raportin me amendamente. Por, gjatë hartimit të kolonës së tretë, në inkuorporimin e amendamenteve, në tekstin final të projektligjit, është vërejtur që duhet të ndryshohen tre amendamente teknikisht:

- Amendamenti 23, Kapitulli XII - ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës. Ky projektligj tashmë është në Kuvend dhe është konsumuar nxjerrja e akteve nënligjore me projektligjin tani që e kemi për nxjerrjen e akteve nënligjore. Për këtë, është propozuar që të fshihet tërësisht ky kapitull nga teksti aktual. Andaj, është një gabim të referenca, ku kemi thënë se të neni 32, me tre paragrafët, neni 33 dhe 34. Vetëm është rekomanduar të fshihet prej nenit 32 të projektligjit kjo referencë. Pjesa tjetër mbetet, fshihet në tërësi dhe renditja e neneve bëhet sipas këtij ndryshimi.
- Amendamenti 35 - ligji bazik ka pesë paragrafët. Meqenëse këtu është propozuar paragrafi 3, kurse në ligj bazik është paragrafi 3, kemi propozuar që të bëhet 2A, siç e kemi në praktikën e hartimit të akteve normative.
- Amendamenti 12, Kapitulli XI - ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për verërat, i cili është miratuar në korrik të këtij viti, është ligji i ri në fuqi që është miratuar nga ana e Kuvendit. Ndërsa, projektligji është thirrur në ligjin e vjetër, tashmë të shfuqizuar, andaj është rekomanduar të fshihet. Këtu vetëm kemi thënë që ky ndryshim pasqyrohet edhe në nenin 2, të qëllimi i projektligjit, ku citohen në renditje hierarkike, të gjitha ndryshimet dhe plotësimet të cilat janë prekur me këtë ligj.

*Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe një kundër, miratoi raportin përfundimtar të projektligjit, me vërejtjet e paraqitura si më sipër dhe vendosi që Kuvendit, t'ia paraqesë këtë:*

**R a p o r t**

## **Për Projektligjin nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat**

### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative**

**Kryetari**, tha se pas miratimit në lexim të parë dhe themelimit të grupit të punës, është bërë përpjekje që në shqyrtim me aktorë të ndryshëm institucionalë, partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile, të trajtohet projektligji në mes të dy leximeve, nen për nen. Raporti me amendamente i paraqitur përmban 17 amendamente.

**Driton Selmanaj**, tha se po merr pjesë në këtë mbledhje, pikërisht për këtë projektligj. Ai theksoi se, ashtu si herën e kaluar, kur është bërë Gjykata Komerciale në Kosovë, është vendosur një praktikë që ai nuk po e sheh askund. As në vendet e rajonit, as në Evropë, ku dyshkallshmëria tretet në një gjykatë dhe me një kryetar gjykate. Po ashtu, tha se nëse mbrojmë idenë themelore të pavarësisë së institucioneve dhe gjyqësorit, jemi duke e shkatërruar këtë. Mendon se është bërë shumë gabim me Gjykatën Komerciale, dhe fatkeqësisht sa ka mundur të shohë se në amendamente nuk është arritur të reflektohet, është po ajo situatë. Pra, Gjykata Administrative, dy shkallët i ka brenda një institucioni që e udhëheq një kryetar dhe kjo vetëm pavarësi nuk është. Ndërkaq, theksoi se ka parë një analizë të KDI-së, ku pothuajse përfshihen të gjitha vendet e Evropës dhe Ballkanit. Është marrë model Kroacia dhe Gjermania, si referenca ku Qeveria e ka dhënë idenë për këtë projektligj, por në asnjë prej këtyre vendeve nuk trajtohet kështu. Çështjen e Gjykatës Komerciale nuk e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese, por sipas tij, kjo e fundit do ta rrëzonte. Një kryetar gjykate të dy shkallëve nuk ka askund, ndërsa tek ne, është vendosur të replikohet sërish.

Gjithashtu, sa i përket juridiksionit, tha se janë marrë të gjitha çështjet që lidhen me kontestet e marrëdhënies së punës, mes personave fizikë dhe institucioneve publike dhe këtë e konsideron gabim, sepse sipas tij, ishte dashur të mbetet te gjykatat e rregullta, kjo pjesë, jo te Gjykata Administrative. Vendet tjera kanë gjykata të punës, por ne nuk kemi, dikur e kemi pasur, e kemi shuar dhe tani është dërguar te Gjykata Administrative, që nuk mendon se ka as ekspertizë të mjaftueshme.

Ndërsa, sa i përket shkallës së tretë edhe në rastin e Gjykatës Komerciale, shkallën e tretë e kemi lënë në sistemin tonë kushtetues, Gjykatën Supreme. Ndërkohë, kemi themeluar gjykata të specializuara dhe nuk kemi thënë se në kuadër të Gjykatës Supreme duhet të ketë së paku degë të specializuara për ta trajtuar këto çështje. Kjo do të thotë, gjykatë të specializuar në konteste tregtare, komerciale duke pohuar se gjyqtarët e specializuar janë aty ose supozon se gjyqtarët janë të specializuar, por, kur çështja shkon në mjetin e jashtëzakonshëm juridik, që të trajtohet në Gjykatën Supreme, atëherë aty gjykojnë gjyqtarë që ndoshta gjithë jetën e tyre kurrë nuk kanë pasur objekt trajtimi çështjet komerciale dhe tregtare. Pra, kjo gjë po ndodh edhe këtu në shkallën e tretë, mund të shkojë rasti te gjyqtari që kurrë nuk ka pasur çështje me konteste administrative ose të punës. Prandaj, është i bindur që kjo është kundërkushtetuese, edhe pse në fund të mandatit, konsideron se jemi të detyruar që nëse e kalojmë këtë në lexim të dytë, ta procedojmë në Gjykatë Kushtetuese, dhe më pas, në bazë të këtij parimi, të shikohet edhe Gjykata Komerciale. Nuk po e bën këtë për të penguar themelimin e një gjykate të specializuar, sepse kështu është ideja, por

për të mbrojtur sistemin dhe rendin kushtetues që kemi ndërtuar. Pavarësia e gjyqësorit është elementi themelor, pastaj barazia e palëve në procedurë, e të gjitha këto, të drejtat e njeriut dhe evitimi i shkeljeve maksimale. Në fund, tha se Gjykatën Komerciale dhe Gjykatën Administrative i sheh si të këqija të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

**Artan Abrashi**, e konsideron të domosdoshme themelimin e Gjykatës Administrative, dhe mbi bazën e përvojës që ka pasur në instancë të pushtetit lokal, ka ndodhur situata, në të cilën një çështje që ka pasur tërësisht karakter administrativ, kur është dërguar të kontestohet në gjykatë, i është dhënë menjëherë ngjyrë penale. Pra, ky ka qenë një problem shumë i madh. Si shembull, rastin kur një drejtor ka nënshkruar një vendim, ku nuk është respektuar afati kohor ose janë tejkaluara kompetenca dhe në vend se të trajtohet administrativisht, menjëherë ka nisur çështja dhe është proceduar penalisht. Kjo pasi nuk ka ekzistuar një institucion që ka në kompetencë trajtimin administrativ të rasteve dhe këtu ndërlidhet te domosdoshmëria që përmes Gjykatës Administrative, kjo çështje qartësohet. Pra, qartësohet kompetenca lëndore, dihet cilat janë aktet administrative që kërkojnë trajtim, rastet kur është nxjerrë një vendim dhe nuk është respektuar afati kohor, kjo hyn në kuadër të shqyrtimit administrativ. Ose kur një drejtori e ka tejkaluara kompetencën, qoftë lëndore apo qoftë territoriale, e shqyrton Gjykata Administrative. Po ashtu, tha se vendoset në binarë sistemi juridik. Ndërsa, sa i përket çështjes së instancave, nuk ka koment, mirëpo mendon se Gjykata Administrative, si koncept i tillë, është jashtëzakonisht e nevojshme.

**Driton Selmanaj**, tha se mund të pajtohet me idenë që të themelohet, sepse kjo çështje fundja është çështje e politikave të qeverive dhe ka shtete që i kanë, por ka edhe shtete që nuk i kanë. Pra, janë vlerësime subjektive, por të vlerësueshme. Duhet të shikohen të gjitha rrethanat, duke përfshirë rastet që nuk kanë lidhje me çështje penale, por janë referuar si të tilla. Por, problemi është se si do të bëhet kjo dhe është politikë e kësaj Qeverie të kemi Gjykatën Administrative. Më tej, shprehu se në parim, është kundër rikthimit të sistemit që ka qenë para vitit 2013, ku ka pasur Gjykatë për Kundërvajtje, e që në shumicën e rasteve kanë qenë kontestet administrative, pastaj dhe Gjykatë Ekonomike apo edhe Gjykatë të Punës. Pra, të gjitha i kemi pasur, por nga ndërkombëtarët është thënë të shuhen dhe të inkorporohen në Gjykata Themelore, të bëhen degët e veçanta, një Gjykatë të Apelit, e kështu me radhë. Ndërsa, tani na thonë se është mirë t'i ktheni si i keni pasur dhe këtë e sheh si eksperiment, duke pohuar se nuk po flet për nevojën, po për formën e Gjykatës Administrative, me të cilën nuk pajtohet. Në fund, tha se më tregoni vetëm një shembull të një vendi që funksionon një gjykatë me një kryetar të gjykatës, me dy shkallë brenda vetes.

**Kryetari**, tha se këto janë diskutuar në grupin e punës dhe ka pasur argumente pro dhe kundër edhe nga pjesëtarët dhe pjesëmarrësit në takimin e grupit të punës. Ka qenë insistim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të mbetet modeli i dy niveleve me një kryetar të përbashkët. Argumenti përgjithësisht është që kryetari ka rol menaxhues, nuk përfshihet në panele dhe vendimmarrje. Kjo ka të bëjë edhe me resurset e tyre. Kryetari nuk mendon se e cenon në thelb vendimmarrjen. Në princip nuk kanë qenë kundër rregullimit me dy kryetarë për dy nivele. Por, kërkesa dhe argumenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që ka përgjegjësinë e emërimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve, ka mbizotëruar dhe është vazhduar tutje. Është e vërtetë që në Gjykatën Komerciale është organizimi i njëjtë, në dy nivelet, një kryetar të përbashkët që drejton. Deputeti Selmanaj mund ta procedojë në Gjykatë Kushtetuese, nuk ka asnjë problem, shprehet kryetari. Sa i përket çështjes së dytë, se të gjitha marrëdhëniet e punës me organe publike janë përfshirë

në juridiksionin e kësaj gjykate, kryetari mendon se është mirë që ka ndodhur kështu. Aktiviteti më intensiv administrativ është pikërisht marrëdhënia e punës me institucione publike. Nëse kjo do të eliminohej, atëherë në masë të madhe do t'i humbte kuptimi. Në anën tjetër, duke qenë se synimi i kësaj politike publike është themelimi i një gjykate të specializuar, nuk do të kishte kuptim pastaj që disa çështje administrative të lihen në gjykata të rregullta e disa çështje administrative t'i barten kësaj gjykate. Ose i barten të gjitha çështjet administrative, ose nuk themelohen fare. Kur specializohen, duhet të fokusohet në të gjitha çështjet administrative, në çfarëdo raporti me organin publik.

**Besnik Tahiri**, tha se kur është diskutuar kjo temë, themelimi i gjykatave specifike, që në të kaluarën kanë qenë departamente, përmes ligjit i është dhënë mbështetja themelimit të Gjykatës Komerciale. Tani jemi në proces të themelimit të Gjykatës Administrative. Deputeti thotë se në parim, gjithnjë është pro decentralizimit të pushtetit, mirëpo është mirë që çfarëdo institucioni i ri që themelohet, të mos bie ndesh. Ajo që kërkon në komision është që të ketë një vlerësim të punës së Gjykatës Komerciale, angazhimit të saj, lëndëve dhe integritetit deri tani. Për shkak se si komision duhet të dijë pak a shumë çfarë ka përfituar qytetari i Kosovës, sistemi i drejtësisë, me themelimin dhe me udhëheqjen e kësaj gjykate. Deputeti e ngriti këtë çështje, sepse e sheh si shumë të rëndësishme. Gjykata Komerciale është themeluar që dy vite, andaj është mirë t'i bëhet një vlerësim, të shihet si janë procedurat. A ka pasur sukses ky modelim dhe si po udhëhiqet kjo?

**Kryetari** pajtohet me këtë ide, që të bëhet një lloj mbikëqyrje dhe vlerësim i efekteve që ka pasur, si ka funksionuar dhe si është drejtuar Gjykata Komerciale, por kjo çështje i mbetet legjislaturës së ardhshme. Në disa aspekte komerciale dhe tregtare duket sikur ia ka vlejtur themelimi i Gjykatës Komerciale. Por, në aspektin administrativ, të dhënat janë goxha problematike, përfundon ai.

*Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe dy kundër, miratoi raportin me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe komisioneve kryesore, t'ua paraqesë këtë:*

## **R a p o r t**

### **Për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative**

#### **5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror**

**Kryetari**, tha se Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ka paraqitur 33 amendamente. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafin 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligjet dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me gjashtë vota për, u miratua raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë:*

## **Rekomandim**

1. Projektligji nr.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **6. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----